



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

Nr _____ Prot.

Tiranë, me ____/____/2020

Lënda: Dërgohet për botim një Ftesë për Ofertë

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

Bazuar në nenin 5 pika 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikës 6 dhe 7, 9 (b, c) të VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar, VKM nr.248, datë 02.05.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.347, datë 29.04.2011, “Për miratimin e programit të veprimit 3 vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”, VKM Nr.664, datë 10.10.2019 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2019 – 2021, në zbatim të strategjisë minerare”, Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nr. 588, datë 02.08.2011 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2011”, Urdhrit të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 107, datë 10.03.2014 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2014” dhe Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 441, datë 04.12.2019, “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2019”, bashkëlidhur gjeni për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike, Ftesën për Ofertë, për organizimin e procedurës konkurruese për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën Kombëtare të Biznesit për zonat minerare konkurruese **Nr. 326/6, Nr. 364/1, Nr. 364/2, Nr. 47, Nr. 327/2, Nr. 436/1, Nr. 780/5, Nr. 371/2, Nr. 321/1.**

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

MINISTRI

Belinda Balluku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, me ____/____/2020

FTESË PËR OFERTË

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në nenin 5 pika 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 36/1 të Ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, pikës 6 dhe 7, 9 (b, c), të VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar, VKM nr.248, datë 02.05.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.347, datë 29.04.2011, “Për miratimin e programit të veprimit 3 vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”, VKM Nr.664, datë 10.10.2019 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2019 – 2021, në zbatim të strategjisë minerare”, Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nr. 588, datë 02.08.2011 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2011”, Urdhrit të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 107, datë 10.03.2014 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2014” dhe Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 441, datë 04.12.2019, “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2019”, shpall ftesën për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën Kombëtare të Biznesit për zonat minerare konkurruese **Nr. 326/6, Nr. 364/1, Nr. 364/2, Nr. 47, Nr. 327/2, Nr. 436/1, Nr. 780/5, Nr. 371/2, Nr. 321/1.**

2. Kërkohet që të realizohet aplikimi për leje minerare për zonat minerare konkurruese **Nr. 326/6, Nr. 364/1, Nr. 364/2, Nr. 47, Nr. 327/2, Nr. 436/1, Nr. 780/5, Nr. 371/2, Nr. 321/1**, të miratuara në planet vjetore të viteve 2011, 2014 dhe 2019, me të dhënat dhe formën e formularit të ofertës të paraqitura në aneksin 1 të kësaj Ftesë për Ofertë.

3. Kërkesat për kualifikim dhe kriteret e konkurrimit dhe vlerësimit të ofertave për të drejtën e aplikimit për një leje minerare në zonat konkurruese jepen në përputhje me Ligjin Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar, VKM nr.248, datë 02.05.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.347, datë 29.04.2011, “Për miratimin e programit të veprimit 3 vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”, VKM Nr.664, datë 10.10.2019 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2019 – 2021, në zbatim të strategjisë minerare”, Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nr. 588, datë 02.08.2011 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2011”, Urdhrit të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 107, datë 10.03.2014 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2014” dhe Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 441, datë 04.12.2019, “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2019”.

4. Ofertuesit të paraqesin vetëm një Ofertë për një zonë konkurruese, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurë konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i procedurës konkurruese. Shpenzimet e kryera për të marrë pjesë në procedurën konkurruese nuk rimbursohen nga Autoriteti Kontraktues.

5. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuar, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese dhe të dërgohen tek **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në adresën: Rr. "Abdi Toptani", Nr. 1, Tiranë.**

6. Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit në bazë të shtetësisë.

7. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është:

Për zonat: Nr. 326/6, Nr. 364/1, Nr. 364/2, Nr. 47, Nr. 327/2; dt. 04.03.2020, ora 10⁰⁰

Për zonat: Nr. 436/1, Nr. 780/5, Nr. 371/2, Nr. 321/1; dt. 05.03.2020, ora 10⁰⁰

8. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.

9. Ofertat do të hapen në **Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në Sallën e Mbledhjeve, Kati i parë,**

Për zonat: Nr. 326/6, Nr. 364/1, Nr. 364/2, Nr. 47, Nr. 327/2; dt. 04.03.2020, ora 10⁰⁰

Për zonat: Nr. 436/1, Nr. 780/5, Nr. 371/2, Nr. 321/1; dt. 05.03.2020, ora 10⁰⁰

10. Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.

KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

Belinda Balluku

ANEKSI I

Të dhëna për zonën minerare konkurruese Nr. 326/6, të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2019, që shpallet në procedurë konkurruese për të drejtën e aplikimit për një leje minerare.

Zona minerare Nr. 326/6 (Objekti Macuklli), Mat, Qarku Dibër, e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2019, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 441, datë 04.12.2019 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2019”, e përfshirë në qarkun Dibër.


Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese Nr. 326/6

Emri i objektit minerar	Lloji i Mineralit	Rezervat në ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Sipërfaqja e zonës km ²	Pika	X	Y
Objekti Macuklli, Mat, Qarku Dibër	Gëlqeror i mermerizuar	1 000 000	55 % CaO	shfrytëzim	0.523	1	4613990	4429200
						2	4614100	4428250
						3	4614350	4427850
						4	4614670	4427900
						5	4614300	4429200

Kriteret minimale për zonën konkurruese Nr. 326/6

Emri i objektit minerar	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Vlera minimale e sipërfaqes km ²	Sasia minimale e prodhimit, ton ose m ³ /vit	Vlera minimale e investimit (pa TVSH) mln leke/ për prodhimin vjetor minimal
Objekti Macuklli, Mat, Qarku Dibër	shfrytëzim	0.02	1 000	26

Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare konkurruese Nr. 326/6



ANEKSI I

Të dhëna për zonën minerare konkurruese Nr. 364/1, të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2019, që shpallet në procedurë konkurruese për të drejtën e aplikimit për një leje minerare.

Zona minerare Nr. 364/1 (Objekti Kodra e Trullit), Qarku Kukës, e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2019, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 441, datë 04.12.2019 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2019”, e përfshirë në qarkun Kukës.

Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese Nr. 364/1


Emri i objektit minerar	Lloji i Mineralit	Rezervat në ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Sipërfaqja e zonës km ²	Pika	X	Y
Objekti Kodra e Trullit, Qarku Kukës	Hekur - Nikel	3 680 158	Fe 35 - 48 % Ni 0.9–1.2 %	Shfrytëzim	0.927	1	4656305	4448000
						2	4656303	4448319
						3	4655875	4448321
						4	4655840	4447459
						5	4655717	4447308
						6	4655717	4447082
						7	4655733	4447060
						8	4655755	4447144
						9	4656005	4447072
						10	4656004	4446688
						11	4656106	4446547

						12	4656578	4446105
						13	4657665	4446734
						14	4657582	4446868
						15	4656605	4446250
						16	4656000	4448000

Kriteret minimale për zonën konkurruese Nr. 364/1

Emri i objektit minerar	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Vlera minimale e sipërfaqes km ²	Sasia minimale e prodhimit, ton ose m ³ /vit	Vlera minimale e investimit (pa TVSH) mln leke/ për prodhimin vjetor minimal
Objekti Kodra e Trullit, Qarku Kukës	Shfrytëzim	0.05	50 000	97.5

Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare konkurruese Nr. 364/1



ANEKSI I

Të dhëna për zonën minerare konkurruese Nr. 364/2, të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2019, që shpallet në procedurë konkurruese për të drejtën e aplikimit për një leje minerare.

Zona minerare Nr. 364/2 (Objekti Kodra e Trullit), Qarku Kukës, e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2019, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 441, datë 04.12.2019 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2019”, e përfshirë në qarkun Kukës.


Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese Nr. 364/2

Emri i objektit minerar	Lloji i Mineralit	Rezervat në ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Sipërfaqja e zonës km ²	Pika	X	Y
Objekti Kodra e Trullit, Qarku Kukës	Hekur - Nikel	3 001 294	Fe 35 - 48 % Ni 0.9–1.2 %	Shfrytëzim	0.756	1	4654000	4444000
						2	4654000	4443500
						3	4654818	4443480
						4	4654190	4444041
						5	4655567	4444581
						6	4655567	4445046
						7	4654800	4445033
						8	4654800	4444300

Kriteret minimale për zonën konkurruese Nr. 364/2

Emri i objektit minerar	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Vlera minimale e sipërfaqes km ²	Sasia minimale e prodhimit, ton ose m ³ /vit	Vlera minimale e investimit (pa TVSH) mln leke/ për prodhimin vjetor minimal
Objekti Kodra e Trullit, Qarku Kukës	Shfrytëzim	0.05	50 000	97.5

Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare Nr. 364/2



ANEKSI I

Të dhëna për zonën minerare konkurruese Nr. 47 të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2011, që shpallet në procedurë konkurruese për të drejtën e aplikimit për leje minerare.

***Zona minerare Nr.47** (Objekti Skatinë), Qarku Kukës, e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2011, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nr. 588, datë 02.08.2011 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2011”, e përfshirë në qarkun Kukës.*


Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese Nr. 47

Emri i objektit minerar	Lloji i Mineralit	Rezervat në ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Sipërfaqja e zonës km ²	Pika	X	Y
Objekti Skatinë, Qarku Kukës	Krom	108 000	27 % Cr ₂ O ₃	Shfrytëzim	0.083	1	4682000	4441000
						2	4681800	4441200
						3	4681600	4440800
						4	4681830	4440800

Kriteret minimale për zonën konkurruese Nr. 47

Emri i objektit minerar	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Vlera minimale e sipërfaqes km ²	Sasia minimale e prodhimit, ton ose m ³ /vit	Vlera minimale e investimit (pa TVSH) mln leke/ për prodhimin vjetor minimal
Objekti Skatinë, Qarku Kukës	Shfrytëzim	0.02	1 000	7.8

Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare Nr. 47



ANEKSI I

Të dhëna për zonën minerare konkurruese Nr. 327/2, të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2019, që shpallet në procedurë konkurruese për të drejtën e aplikimit për një leje minerare.

Zona minerare Nr. 327/2 (Objekti Mertur), Fushë Arrëz, Qarku Shkodër, e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2019, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 441, datë 04.12.2019 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2019”, e përfshirë në qarkun Shkodër.


Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese Nr. 327/2

Emri i objektit minerar	Lloji i Mineralit	Rezervat në ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Sipërfaqja e zonës km ²	Pika	X	Y
Objekti Mertur, Fushë Arrëz, Qarku Shkodër	Gëlqeror i mermerizuar	150 000	54 % CaO	Shfrytëzim	0.111	1	4678875	4412685
						2	4678614	4413088
						3	4678380	4413080
						4	4678386	4412882
						5	4678505	4412850
						6	4678550	4412727

Kriteret minimale për zonën konkurruese Nr. 327/2

Emri i objektit minerar	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Vlera minimale e sipërfaqes km ²	Sasia minimale e prodhimit, ton ose m ³ /vit	Vlera minimale e investimit (pa TVSH) mln leke/ për prodhimin vjetor minimal
Objekti Mertur, Fushë Arrëz, Qarku Shkodër	Shfrytëzim	0.02	1 000	26

Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare Nr. 327/2



ANEKSI I

Të dhëna për zonën minerare konkurruese Nr. 436/1, të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2019, që shpallet në procedurë konkurruese për të drejtën e aplikimit për një leje minerare.

Zona minerare Nr. 436/1 (Objekti Cukaj - Krastë), Bulqizë, Qarku Dibër, e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2019, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 441, datë 04.12.2019 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2019”, e përfshirë në qarkun Dibër.


Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese Nr. 436/1

Emri i objektit minerar	Lloji i Mineralit	Rezervat në ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Sipërfaqja e zonës km ²	Pika	X	Y
Objekti Cukaj - Krastë, Bulqizë, Qarku Dibër	Krom	4 480	24 % Cr2O3	Shfrytëzim	0.103	1	4587684	4434823
						2	4588018	4434871
						3	4587938	4435020
						4	4588080	4435082
						5	4588096	4435240
						6	4587808	4435149
						7	4587679	4434993

Kriteret minimale për zonën konkurruese Nr. 436/1

Emri i objektit minerar	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Vlera minimale e sipërfaqes km ²	Sasia minimale e prodhimit, ton ose m ³ /vit	Vlera minimale e investimit (pa TVSH) mln leke/ për prodhimin vjetor minimal
Objekti Cukaj - Krastë, Bulqizë, Qarku Dibër	Shfrytëzim	0.02	1 000	7.8

Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare Nr. 436/1



ANEKSI I

Të dhëna për zonën minerare konkurruese Nr. 780/5, të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2019, që shpallet në procedurë konkurruese për të drejtën e aplikimit për një leje minerare.

Zona minerare Nr. 780/5 (Objekti Mali i Kaltanjit), Qarku Korçë, e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2019, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 441, datë 04.12.2019 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2019”, e përfshirë në qarkun Korçë.


Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese Nr. 780/5

Emri i objektit minerar	Lloji i Mineralit	Rezervat në ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Sipërfaqja e zonës km ²	Pika	X	Y
Objekti Mali i Kaltanjit, Qarku Korçë	Gëlqeror masiv (Gur Dekorativ)	200 000	54.18 % CaO	Shfrytëzim	0.294	1	4477580	4459138
						2	4478005	4459050
						3	4478198	4458941
						4	4478386	4458806
						5	4478708	4458774
						6	4478746	4458989
						7	4478507	4459086
						8	4478331	4459162
						9	4478009	4459257
						10	4477836	4459462

Kriteret minimale për zonën konkurruese Nr. 780/5

Emri i objektit minerar	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Vlera minimale e sipërfaqes km ²	Sasia minimale e prodhimit, ton ose m ³ /vit	Vlera minimale e investimit (pa TVSH) mln leke/ për prodhimin vjetor minimal
Objekti Mali i Kaltanjit, Qarku Korçë	Shfrytëzim	0.02	1 000	26

Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare Nr. 780/5



ANEKSI I

Të dhëna për zonën minerare konkurruese Nr. 371/2, të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2014, që shpallet në procedurë konkurruese për të drejtën e aplikimit për një leje minerare.

Zona minerare Nr. 371/2 (Objekti Floq), Qarku Korçë, e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2014, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 107, datë 10.03.2014 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar për Vitin 2014”, e përfshirë në qarkun Korçë.


Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese Nr. 371/2

Emri i objektit minerar	Lloji i Mineralit	Rezervat në ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Sipërfaqja e zonës km ²	Pika	X	Y
Objekti Floq, Qarku Korçë	Gëlqeror pllakor	6 000 000	48 - 51 % CaO	Shfrytëzim	0.338	1	4484100	4476200
						2	4484650	4476200
						3	4484520	4477000
						4	4484100	4477000

Kriteret minimale për zonën konkurruese Nr. 371/2

Emri i objektit minerar	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Vlera minimale e sipërfaqes km ²	Sasia minimale e prodhimit, ton ose m ³ /vit	Vlera minimale e investimit (pa TVSH) mln leke/ për prodhimin vjetor minimal
Objekti Floq, Qarku Korçë	Shfrytëzim	0.02	1 000	26

Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare Nr. 371/2



ANEKSI I

Të dhëna për zonën minerare konkurruese Nr. 321/1, të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2019, që shpallet në procedurë konkurruese për të drejtën e aplikimit për një leje minerare.

Zona minerare Nr. 321/1 (Objekti Mbreshtan), Qarku Berat, e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2019, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 441, datë 04.12.2019 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2019”, e përfshirë në qarkun Berat.


Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese Nr. 321/1

Emri i objektit minerar	Lloji i Mineralit	Rezervat në ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Sipërfaqja e zonës km ²	Pika	X	Y
Objekti Mbreshtan, Qarku Berat	Gëlqeror pllakor	180 000	54.9 % CaO	Shfrytëzim	0.135	1	4512412	4405046
						2	4512552	4405008
						3	4512752	4405334
						4	4512853	4405310
						5	4512755	4405524
						6	4512604	4405702

Kriteret minimale për zonën konkurruese Nr. 321/1

Emri i objektit minerar	Lloji i veprimtarisë minerare kërkim-zbulim dhe/ose shfrytëzim	Vlera minimale e sipërfaqes km ²	Sasia minimale e prodhimit, ton ose m ³ /vit	Vlera minimale e investimit (pa TVSH) mln leke/ për prodhimin vjetor minimal
Objekti Mbreshtan, Qarku Berat	Shfrytëzim	0.02	1 000	26

Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare Nr. 321/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DOKUMENTET STANDARDE TË PROCEDURËS KONKURUESE
PËR PËRFITIMIN E TË DREJTËS PËR APLIKIM PRANË INSTITUCIONIT TË QKB
PËR LEJE MINERARE PËR

1. Zonën minerare Nr. 326/6, Objekti “Macuklli”, Mat, Qarku Dibër, lloji i mineralit gëlqeror i mermerizuar, veprimtaria shfrytëzim.
2. Zonën minerare Nr. 364/1, Objekti “Kodra e Trullit”, Qarku Kukës, lloji i mineralit hekur - nikel, veprimtaria shfrytëzim.
3. Zonën minerare Nr. 364/2, Objekti “Kodra e Trullit”, Qarku Kukës, lloji i mineralit hekur - nikel, veprimtaria shfrytëzim.
4. Zonën minerare Nr. 47, Objekti “Skatinë”, Qarku Kukës, lloji i mineralit krom, veprimtaria shfrytëzim.
5. Zona minerare Nr. 327/2, Objekti “Mertur”, Fushë Arrëz, Qarku Shkodër, lloji i mineralit gëlqeror i mermerizuar, veprimtaria shfrytëzim.
6. Zona minerare Nr. 436/1, Objekti “Cukaj - Krastë”, Bulqizë, Qarku Dibër, lloji i mineralit krom, veprimtaria shfrytëzim.
7. Zona minerare Nr. 780/5, Objekti “Mali i Kaltanjit”, Qarku Korçë, lloji i mineralit gëlqeror masiv, veprimtaria shfrytëzim.
8. Zona minerare Nr. 371/2, Objekti “Floq”, Qarku Korçë, lloji i mineralit gëlqeror pllakor, veprimtaria shfrytëzim.
9. Zona minerare Nr. 321/1, Objekti “Mbreshtan”, Qarku Berat, lloji i mineralit gëlqeror pllakor, veprimtaria shfrytëzim.

UDHËZIM PËR OFERTUESIT

Procedura e konkurrimit do të kryhet në përputhje me procedurat e konkurrimit të përcaktuara në VKM nr. 320, datë 21, 04, 2011 “Për miratimin e procedurave e të kritereve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, të ndryshuar.

Çdo “Ofertues” ftohet të dorëzojë ofertë për një zonë minerare konkurruese. E drejta e aplikimit për leje minerare do t’i akordohet atij ofertuesi që plotëson kërkesat për kualifikim dhe ka dorëzuar ofertën tekniko-financiare e vlerësuar me numrin maksimal të pikëve.

Një ofertë deklarohet e pavlefshme nëse ofertuesi:

- a) ka dhënë të dhëna të rreme në ofertën e tij;
- b) nuk ka plotësuar një nga tre kërkesat e ftesës për ofertë në procedurë konkurruese (kriteri ligjor, profesional, ekonomiko - financiar);
- c) paraqitet me ortak shtetin;

Procedura konkurruese do të quhet e pasuksesshme, kur:

- a) asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbush kërkesat e ftesës për procedurë konkurruese;
- b) autoriteti kontraktues, për mungesë të leverdisë ekonomike të ofertave, shpall mbylljen e procedurës konkurruese;

Termat e përdorura në Dokumentet e Procedurës Konkurruese kanë kuptimet e mëposhtme:

- 1. “Ofertuesi” ose “Ofertuesit” janë subjekte juridike, që kanë për qëllim të marrin pjesë apo që marrin pjesë në një procedurë përzgjedhjeje, në lidhje me një procedure konkurruese.
- 2. “Procedurë konkurruese” është procedura për përzgjedhjen e subjektit fitues për të drejtën e aplikimit të lejes minerare pranë institucionit të QKB.
- 3. “Autoritet kontraktues” është autoriteti kompetent për zhvillimin e procedurës konkurruese
- 4. “Komisioni i Prokurimit Publik” është institucioni i ngritur dhe që funksionon sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Mënyrat e komunikimit me ofertuesit

I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit (korrespondenca) ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Ofertuesit duhet të bëhet me shkrim.

Në veçanti, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit kryhet me shkresë nëpërmjet postës dhe/ose mjeteve elektronike (në adresën e internetit të MIE). Do të konsiderohet se korrespondenca është dorëzuar në kohën e duhur, nëse përmbajtja e saj me shkrim, ka mbërritur tek Autoriteti Kontraktues para skadimit të afatit kohor.

Autoriteti Kontraktues me nismën e vet, apo si rezultat i një kërkesë për sqarim nga një ofertues, mund të rishikojë dhe sipas rastit të ndryshojë çdo element të procedurës konkurruese.

Çdo ndryshim u njoftohet menjëherë të gjithë ofertuesve, që kanë dorëzuar një Ofertë. Kur Autoriteti kontraktues e vlerëson të nevojshme të ndryshojë dokumentet dhe kjo bëhet brenda një periudhe kohe më

pak se 1/3 e numrit të ditëve të përcaktuara për përgatitjen e ofertave, duhet ta shtyjë afatin e fundit të paraqitjes së ofertave për të njëjtën periudhë kohe.

Asnjë përgjigje mbi pyetjet e ngritura nga ofertuesit lidhur me Dokumentet standarde të ofertës dhe/ose informacion i dhënë formalisht, apo me shkrim nuk do të jetë detyrues për palët.

Hartimi i ofertës

Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të procedurës konkurruese. Në të kundërt, ato do të refuzohen si të papranueshme.

Ofertuesi përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktues nuk është përgjegjës për këto kosto.

Oferta dhe të gjithë dokumentet, si dhe korrespondenca që lidhet me ofertën, e shkëmbyer ndërmjet Ofertuesit dhe Autoriteti Kontraktues duhet të përgatitën në gjuhën shqip. Materialet mbështetëse dhe literatura e printuar, që paraqitet nga Ofertuesi mund të jetë e shkruar edhe në një gjuhë tjetër që përdoret gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare, me kusht që këto dokumente të shoqërohen me përkthimin e duhur në gjuhën e ofertës, të fragmenteve përkatëse.

Kërkesat për sqarime duhet të paraqitën me shkrim dhe përgjigjet përkatëse të Autoritetit kontraktues duhet t'u dërgohen të gjithë ofertuesve që kanë kërkuar dokumentet e procedurës konkurruese, pa asnjë përjashtim.

Origjinali dhe kopjet e ofertës duhet të shtypen ose të shkruhen me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar, duhet të pajisen me initiale ose të nënshkruhen nga personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në kërkesë/ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e autorizuar.

Oferta duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtëm:

- a) Dokumentet standarde për plotësimin e kriterëve kualifikuese që lidhen me objektin e procedurës konkurruese.
- b) Ofertën tekniko-financiare, në përputhje me Aneksin IV.

Një Ofertues duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Fshehtësia

Autoriteti Kontraktues i trajton propozimet në mënyrë që të mënjanohet përhapja e tyre tek ofertuesit konkurrues. Çdo diskutim, komunikim dhe negociim ndërmjet Autoritetit Kontraktues, dhe një ofertuesi, mbetën konfidenciale. Nëse nuk parashikohet me ligj, me vendim gjykatë apo nga kërkesa për propozim, asnjëra palë në bisedime nuk i deklaron asnjë personi tjetër asnjë informacion teknik për çmimin apo çdo gjë tjetër për diskutimet, komunikimet dhe bisedimet, në përputhje me dispozitat e mësipërme, pa pëlqimin e palës tjetër.

Jo i gjithë informacioni i dorëzuar nga Ofertuesit do të jetë konfidencial. Një pjesë e informacionit – duke përfshirë edhe atë tregtar, financiar ose teknik do të jetë bërë tashmë publik ose do të bëhet publik në të ardhmen.

Ofertuesit duhet të dorëzojnë ofertën origjinale dhe 1 (një) kopje të saj, duke i shënuar përkatësisht dhe qartë si:

“OFERTË ORIGJINALE” dhe “KOPJE E OFERTËS”. Oferta dhe kopjet e saj duhet të futën në një zarf jo-transparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: **“Ofertë për përfitimin e të drejtës për aplikim për leje minerare për zonën minerare nr....., qarku ”** ;

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA DATËS .../.../2020, ora”.

Secili nga këto zarfe duhet të përmbajë kualifikimet e ofertuesit dhe ofertën teknike -financiare

Oferta tekniko-financiare

Ofertuesi duhet të plotësojë Formularin e Ofertës tekniko-financiare sipas përcaktimeve të formularit të ofertës. Të gjitha vlerat duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse këto vlera kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare dhe kursi i këmbimit duhet të jetë ai i fiksuar nga Banka e Shqipërisë në ditën kur publikohet njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhet në atë kurs këmbimi deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Afati kohor dhe vendi për dorëzimin e ofertave

Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në adresën: Rr. “Abdi Toptani”, Tiranë.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave skadon më ... / / 2020, ora

Ofertat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor do t’i rikthehen të pahapura Ofertuesve përkatës.

Data dhe vendi për hapjen e ofertave

Hapja publike e ofertave do të kryhet më/..../2020, ora, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në Sallën e Mbledhjeve, kati i katërt. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre mund të jenë të pranishëm në hapjen e ofertave. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave duhet t’i komunikohet të gjithë atyre Ofertuesve që kanë dorëzuar oferta në kohën e duhur.

Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Ofertat duhet të jenë të vlefshme për 150 (njeqindpesedhjetë) ditë që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave.

DOKUMENTET E PROCEDURES KONKURUESE

Permbajtja

Aneksi I: Formulari me informacionin bazë;

Aneksi II: Formulari i Sigurimit te Ofertes;

Aneksi III: Vetëdeklarim për kërkesat ligjore;

Aneksi IV: Formulari i ofertës tekniko financiare;

- Aneksi IV - A: Formulari i ofertës tekniko financiare per Leje Shfrytezimi;
- Aneksi IV – B : Formulari i ofertës tekniko financiare per Leje Kerkim Zbulimi;

Aneksi V: Tabela Nr. 1 ;

Aneksi VI: Kriteret e Vlerësimit;

- Aneksi VI- A: Kriteret e Vlerësimit per Leje Shfrytezimi;
- Aneksi VI - B: Kriteret e Vlerësimit per Leje Kerkim Zbulimi;

Aneksi VII: Formularët, ku bejnë pjesë:

- Aneksi VII-1: Formulari i Njoftimit të Fituesit;
- Aneksi VII-2: Formulari i Skualifikimit të Ofertuesve;
- Aneksi VII-3: Formulari i Ankesës së Procedurës Konkurrese;
- Aneksi VII-4: Formulari i Publikimit te Subjektit Fitues;

TË DHËNA PËR PËRGATITJEN DHE PARAQITJEN E OFERTËS

Gjuha e Ofertës duhet të jetë: **Shqip**

Numri i kërkuar i kopjeve: **është 2 (dy), nga të cilat 1 (një) original dhe 1 (një) fotokopje**

Oferta duhet të jetë për një objekt konkurrimit dhe duhet të paraqitet në adresën e mëposhtme:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Rr. “Abdi Toptani”, Tiranë

Zyra e Protokollit , Kati i parë.

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës është:

Për zonat: Nr. 326/6, Nr. 364/1, Nr. 364/2, Nr. 47, Nr. 327/2;

dt. 04.03.2020, ora 10⁰⁰

Për zonat: Nr. 436/1, Nr. 780/5, Nr. 371/2, Nr. 321/1;

dt. 05.03.2020, ora 10⁰⁰

Personi i kontaktit për Autoritetin kontraktues është:

Emri Suela Myftaraj

Adresa: **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. “Abdi Toptani”, Nr. 1, Tiranë.**

Tel: + 355 4 2222245 / 74146

E-mail: suela.myftaraj@infrastruktura.gov.al

FORMA E PARAQITJES SE OFERTËS

Ofertuesi duhet të përgatisë ofertën në dy kopje, të shkruara sipër **“Original”** dhe **“Kopje”**. Çdo set duhet të përbëhet nga dy zarfe të dy të futur në një zarf të madh që do të ketë mbishkrimet e mësipërme.

Të dy Zarfet e mëdhenj duhet t'i drejtohen **Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë** sipas adresës të dhënë më sipër, **me objektin e konkurrimit**, duke shkruar gjithashtu **emrin e ofertuesit**, **adresën** e tij si dhe personin e kontaktit për ofertuesin. Secili nga zarfet duhet të ketë mbishkrimin origjinal ose kopje.

Në çdo zarf të madh duhet të jenë dy zarfe.

Zarfi i parë i ofertës duhet të ketë të shënuar emrin e ofertuesit dhe titullimin për përmbajtjen e tij **“Dokumentacioni i kërkesave për kualifikim”** dhe përmban të gjithë dokumentacionin për plotësimin e kërkesave ligjore, kërkesave për kapacitetet ekonomike dhe financiare, dhe kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional si kusht për plotësimin e kërkesave për kualifikim dhe dokumentet vërtetuese (origjinale ose fotokopje të noterizuara të lëshuara jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës).

Dokumentet që duhet të futen në këtë zarf janë:

I. Formulari me informacionin baze (Aneksi I)

II. Formulari i sigurimit të ofertës (Aneksi II)

III. Dokumenta për plotësimin e kërkesave LIGJORE

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Përveç dokumentave të mësipërme subjektet mund të dorëzojnë edhe vetëdeklarimin sipas Aneksit III “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
- b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.
- c) ka paguar detyrimet për energjinë elektrike, të lëshuar nga Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

3. Ekstraktin historik të subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Ofertuesi i huaj (shoqëri e regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë) duhet të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendur në pikat nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë ato do të pranohen në formën e deklaratës me shkrim, nën përgjegjësinë e ofertuesit. Lidhur me deklarimin e moslëshimit të këtyre vërtetimeve nga institucione të shtetit të origjinës, ofertuesit duhet të paraqesin vërtetim nga Dhoma e Tregtisë së vendit të origjinës – duke evidentuar faktin se ndonjë apo të gjitha vërtetimet e kërkuar nuk lëshohen nga ndonjë institucion publik përgjegjës. Sipas rastit, Autoriteti Kontraktues do të verifikojë nëse këto vërtetime lëshohen apo jo nga institucionet përkatëse në vendin e origjinës, dhe në rast se konstaton zyrtarisht se në shtetin e origjinës ekziston një institucion i cili mund të lëshojë një vërtetim të tillë, të paraqitur nga ofertuesi i huaj në formën e vetëdeklarimit atëherë Komisioni do të quajë të pavlefshëm dokumentin vetëdeklarues të paraqitur. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në shqip.

IV. Dokumenta për plotësimin e kërkesave ekonomiko - financiare

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Kopje të pasqyrave financiare të dy vitëve të fundit, të certifikuar nga Administrata Tatimore;
2. Vertetim të xhiros vjetore të dy vitëve të fundit të leshuara nga Administrata Tatimore;
3. Vërtetim nga Banka që konfirmon se personi juridik ka të depozituara numrin e llogarisë të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar për t' u realizuar në objektin e hedhur për konkurrim të publikuar. Vërtetimi duhet të jete leshuar jo me pare se 30 dite nga dita e hapjes se ofertes;

Në rastet kur ofertuesi ka paraqitur nje dokument noterial me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit, ky dokument duhet të shoqërohet me dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit, si te parashikuara ne pikat 1,2,3 me siper.

V. Dokumenta për plotësimin e kërkesave për Kapacitetet tekniko profesional

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Vërtetime mbi përvojën në fushën minerare apo referenca për përmbushje të suksesshme të punimeve minerare të ngjashme, të leshuara nga një ent publik, ose privat, që tregon vlerën kohen dhe natyrën e punimeve të ekzekutuara, dhe/ose çfarëdolloj dokumenti tjetër që parashikon legjislacioni në fuqi dhe që mund ta vërtetojë një gjë të tillë.
Ne rast se subjekti nuk ka pervoje ne fushen minerare atehere ai duhet te paraqese nje dokument noterial (marreveshje bashkepunimi) ne te cilin shprehet vullneti per mbeshtetje teknike nga nje subjekt me pervoje ne fushen minerare. Subjekti mbeshtetes duhet te vertetoj eksperienцен e tij ne fushen minerare me dokumentacionin e parashikuar ne paragrafin e mesiperm.
2. Historik të aktivitetit të shoqërisë;
3. Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit (CV, diploma, leje profesionale apo dokumenta të tjera të ngjashme);
4. Licenca Profesionale e drejtuesit teknik dhe kontratën me drejtuesin teknik;
5. Dëshmi mbi fuqinë mesatare punetore te ofertuesit dhe stafit drejtues;
6. Lista e mjeteve e shoqëruar me dokumentat që vërtetojnë të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj mjetit (pronësi, qera, përdorim apo çdo lloj tjetër posedimi);

Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin përmbajtjen në zarfin e parë sipas radhës së dokumenteve të dhëna me sipër, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin në përputhje me kërkesat për kualifikim të përcaktuara në këtë pikë.

Zarfi i dytë i ofertës duhet të ketë të shënuar emrin e ofertuesit dhe titullimin për përmbajtjen e tij **“Oferta tekniko-financiare”**.

Dokumentet që duhet të futen në këtë zarf janë:

1. Formulari i Ofertes Tekniko Financiare të ofertuesit sipas Aneksit IV;
2. Tabela Nr. 1 sipas Aneksit V, e plotësuar, si dhe dokumente të tjerë shoqëruese për argumentimin e saj nëse kjo shikohet e arsyeshme nga ofertuesi.

Kujdes në formulimin e ofertës, nuk duhet të ketë forma alternative të paraqitjes së saj. Mosplotësimi korrekt i kërkesave përbën kusht skualifikimi. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës do të jetë: **150 ditë nga hapja e ofertës**. Vlera e projektit të ofruar të shprehet në monedhën: **Lekë**.

PJESËMARRJA DHE KUALIFIKIMI

Kushtet e Përgjithshme për pjesëmarrje.

- **Ofertuesit duhet të paraqesin Sigurimin e ofertës**

Autoriteti Kontraktues ju kërkon të gjithë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas rregullave të prokurimit publik.

Ofertuesi duhet të paraqesë Sigurimin e Ofertës, sipas Formularit të Sigurimit të Ofertës.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e vlerës së projektit të parashikuar nga vet ofertuesi.

Sigurimi i Ofertës duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës të përcaktuara në keto DSPK do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

Sigurimi i Ofertës duhet të dorëzohet në formën e një Garancie bankare të pakushtëzuar.

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka) dhe duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumenti i përmendur më sipër duhet të jetë i vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Autoriteti Kontraktues ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës të ofertës brenda 15 ditëve pasi subjekti i shpallur fitues të ketë depozituar Garacinë Financiare të investimeve.

Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Ofertat duhet të jenë të vlefshme për 150 (ditë) që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave.

Oferta do të quhet e pavlefshme dhe ofertuesi s'kualifikohet në rastin kur ofertuesi nuk ka paraqitur Sigurimin e ofertës sipas Formularit të Sigurimit të Ofertes (Aneksi II).

- **Ofertuesit duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme ligjore të kualifikimit të përcaktuara në keto Dokumenta Standarde të Procedures Konkurese.**

Kërkesat ligjore:

1. Një dokument që vërteton se subjekti juaj nuk është në proces falimentimi.
2. Një dokument që vërteton se subjekti juaj nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

3. Një dokument që vërteton se subjekti juaj nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,
4. Një dokument që vërteton se subjekti juaj ka plotësuar detyrimet fiskale,
5. Një dokument që vërteton se subjekti juaj ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.
6. Një dokument që vërteton se subjekti juaj ka paguar detyrimet për energjinë elektrike, të lëshuar nga Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Oferta do të quhet e pavlefshme dhe ofertuesi s'kualifikohet në rastet kur:

1. Ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;
2. Është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;
3. Është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
4. Nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e detyrimeve fiskale, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
5. Nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
6. Nuk ka paguar detyrimet për energjinë elektrike për Operatorin ekonomik që është regjistruar në Shqipëri, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë;
7. Është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këto Dokumenta Standarde të Procedurës Konkurruese, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

Kriteret e mësipërme përmbushen vetëm nëse dokumentet e paraqitura janë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Kriteret e përcaktuara më lart duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

Shoqëritë ofertuese duhet të jenë të regjistruara në regjistrat përkatës profesionale ose tregtare të shtetit në të cilin ato janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor. Për këtë ofertuesit duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Ofertuesi i huaj (shoqëri e regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë) duhet të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendur në pikat nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë ato do të pranohen në formën e deklaratës me shkrim, nën përgjegjësinë e ofertuesit. Lidhur me deklarimin e moslëshimit të këtyre vërtetimeve nga institucione të shtetit të origjinës, ofertuesit duhet të paraqesin vërtetim nga Dhoma e Tregtisë së vendit të origjinës – duke evidentuar faktin se ndonjë apo të gjitha vërtetimet e kërkuar nuk lëshohen nga ndonjë institucion publik përgjegjës. Sipas rastit, Autoriteti Kontraktues do të verifikojë nëse këto vërtetime lëshohen apo jo nga institucionet përkatëse në

vendin e origjinës, dhe ne rast se konstaton zyrtarisht se ne shtetin e origjinës ekziston një institucion i cili mund të lëshoj një vërtetim të tillë, të paraqitur nga ofertuesi i huaj ne formën e vetëdeklarimit atëherë Komisioni do të quaj të pavlefshëm dokumentin vetëdeklarues të paraqitur. Nëse gjuha e përdorur në procedure është shqip, atëherë dokumentat në gjuhe të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në shqip.

Ne rast të shpalljes fitues, ofertuesi i huaj detyrohet të ngrejë një degë të tij, të regjistruar në Shqipëri konform përcaktimit të Nenit 22/d i Ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” dhe kërkesave të legjislacionit Shqiptarë.

Legalizimi i dokumentacionit

Dokumentet e siguruara jashtë territorit të Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të legalizuara në mënyrë që të kenë vlerë ligjore. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëritë që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës së Hagës (5 TETOR 1961), me përjashtim të vendeve për të cilat ka marrëveshje dypalëshe, duhet të përmbajë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”.

Kriteret Specifike të Kualifikimit

Kërkesat për Kapacitetet ekonomike dhe financiare.

Ofertuesit duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme ekonomike dhe financiare të kualifikimit të përcaktuara në keto Dokumenta Standarde të Procedures Konkurruese.

1. Kopje të pasqyrave financiare të dy vitëve të fundit, të certifikuar nga Administrata Tatimore;

- Vërtetim të xhiros vjetore të dy vitëve të fundit të leshuara nga Administrata Tatimore;

Kriteret që duhet të plotësohen me pasqyrat financiare janë:

i. xhirot vjetore kumulative të dy vitëve të fundit të jetë të paktën sa vlera e përgjithshme e investimit (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi; dhe

ii. kapitali i vet (totali i aktivitetit minus totalin e detyrimeve) i vitit të fundit ushtrimor të jetë të paktën sa 20% e vlerës së përgjithshme të investimit (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi;

Ne rast se xhirot vjetore kumulative të dy vitëve të fundit ushtrimor nuk janë sa vlera e përgjithshme e investimit (pa TVSH), por janë të paktën 60% deri në 100%, atëherë shoqëria kualifikohet për këto kriter

financiar me kushtin që kapitali i vet (totali i aktivitetit minus totalin e detyrimeve) i vitit të fundit ushtrimor të jetë të paktën sa 30% e vlerës së përgjithshme të investimit (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi.

2. Vertetim nga Banka që konfirmon se personi juridik ka të depozituara numrin e llogarisë të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar për t' u realizuar në objektin e hedhur për konkurrim të publikuar. Vertetimi duhet të jete lëshuar jo më parë se 30 dite nga dita e hapjes së ofertës.

Ne rastet kur ofertuesi ka paraqitur një dokument noterial me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit, ky dokument duhet të shoqërohet me dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit, si të parashikuara në pikat 1 dhe 2, më sipër.

Shenim: Mosplotësimi i kriterëve të parashikuar në pikën 1 nuk përben kusht skualifikimi por është i rëndësishëm për vlerësimin e kriterëve ekonomik – financiarë. Kriteri i parashikuar në pikën 2 është kusht i domosdoshëm dhe mosplotësimi i tij përben kusht skualifikimi.

Për rastin e shoqërive që mund të kenë fituar një ose disa procedura konkurrimi, ato duhet të vertëtojnë se, përveç burimeve financiare të deklaruara për projektet e mëparshme, disponojnë burime të tjera financiare të mjaftueshme sipas kriterëve të mësipërme për realizimin e projektit të kësaj procedure konkuruese.

Oferta do të quhet e pavlefshme dhe ofertuesi s'kualifikohet në rastet kur:

1. Nuk vertetohet se ka të depozituara në një bankë të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar për tu realizuar në objektin e publikuar për konkurrim.
2. Investitori, me të cilin është lidhur kontrata e bashkëpunimit për mbështetje financiare nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në këto Dokumenta Standarde të Procedures Konkuruese;

Kriteret Specifike të Kualifikimit

Kërkesat për Kapacitetet tekniko profesionale

Ofertuesit duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme tekniko profesionale të kualifikimit të përcaktuara në këto Dokumenta Standarde të Procedures Konkuruese.

1. Subjektit të mos i jete revokuar asnjë Leje Minerare në tre vitet e fundit, përjashtojë rastet kur subjekti ka hequr dorë nga e drejta minerare sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minier në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Subjekti të vertëtojë se ka përvojë në fushën minerare, të vërtetuar nga referenca për përmbushje të suksesshme të punimeve minerare të ngjashme, të lëshuara nga një ent publik, ose privat, që tregon

vlerën kohen dhe natyrën e punimeve të ekzekutuara, dhe/ose çfarëdolloj dokumenti tjetër që parashikon legjislacioni në fuqi dhe që mund ta vërtetojë një gjë të tillë.

Ne rast se subjekti nuk ka përvorje në fushën minerare atëherë ai duhet të paraqesë një dokument noterial (marreveshje bashkepunimi) në të cilin shprehet vullneti për mbështetje teknike nga një subjekt me përvorje në fushën minerare. Subjekti mbështetës duhet të vërtetojë eksperiencën e tij në fushën minerare me dokumentacionin e parashikuar në paragrafin e mesipër.

3. Historik të aktivitetit të shoqërisë;
3. Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit;
4. Licenca Profesionale e drejtuesit teknik dhe kontratën me drejtuesin teknik;
5. Dëshmi mbi fuqinë mesatare punëtore të ofertuesit dhe stafit drejtues;
6. Lista e mjeteve të shoqëruar me dokumentat që vërtetojnë të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj mjetit (pronësi, qera, përdorim apo çdo lloj tjetër posedimi);

Oferta do të quhet e pavlefshme dhe ofertuesi s'kualifikohet në rastet kur:

1. Autoriteti Kontraktues i ka revokuar subjektin ndonjë Leje minerare në tre vitet e fundit, përjashtojt rastet kur subjekti ka hequr dorë nga e drejta minerare sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Subjekti nuk vërteton përvorjen e tij ose të shoqërisë me të cilën ka kontratë bashkepunimi, në fushën minerare, me dokumentacionin e përcaktuar në keto Dokumenta Standarde të Procedures Konkurruese;
3. Nuk paraqet kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit;
4. Nuk paraqet Licencën Profesionale dhe kontratën me drejtuesin teknik.
5. Drejtuesi teknik nuk plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 11, të VKM nr. 441, datë 16.06.2011.
6. Nuk paraqet dëshmi mbi fuqinë mesatare punëtore të ofertuesit dhe stafit drejtues;
7. Nuk paraqet listën e mjeteve të shoqëruar me dokumente që vërteton të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj mjetit (pronësi, qera, përdorim apo çdo lloj tjetër posedimi);

Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin përmbajtjen në zbatim të parë sipas radhës së dokumenteve të dhëna më sipër duke plotësuar të gjithë dokumentacionin në përputhje me kërkesat për kualifikim. Në të kundërt, nëse qoftë edhe një nga dokumentet e mësipërme nuk janë të plotësuar ato do të refuzohen si të papranueshme, dhe ofertuesi s'kualifikohet.

Veprimet e jashtëligjshme

Në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit, dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues e refuzon një ofertë, nëse ofertuesi që e ka paraqitur atë:

- i ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose të mëparshëm të Autoriteti Kontraktues një dhuratë në kesh ose jo, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim, ose rrjedhën e procedurës konkurruese;
- është në kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si p.sh – një ofertues është i lidhur me një person fizik ose juridik, që është ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues të japë shërbime këshilluese gjatë përgatitjes së projekteve, specifikimeve ose dokumenteve të tjerë lidhur me procedurën konkurruese, apo ka lidhje me anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.
- Ka dorëzuar dokumente/informacione të rreme, që lidhen me kërkesat e paraqitura në ftesën për Ofertë.

Autoriteti Kontraktues e informon me shkrim ofertuesin dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për refuzimin e ofertës, si dhe për arsyet e këtij refuzimi, dhe bën shënimin përkatës në raportin për procedurën e konkurrimit.

HAPJA E OFERTAVE, PROCEDURA

Hapja e Ofertave do të bëhet në :**Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë**, Adresa: **Rr “Abdi Toptani”**, **Tiranë, Salla e Mbledhjeve, Kati i katërt në Datë : .../.../2020, Ora :**

Komisioni i vlerësimit të ofertave fillimisht hap zarfin e madh me mbishkrimin **ORIGINAL**, i cili duhet të përmbajë dy zarfet e tjerë me mbishkrimet zarfi i parë **“Dokumentacioni i kërkesave për kualifikim”** dhe zarfi i dytë **“Oferta tekniko-financiare”**.

Komisioni i vlerësimit të ofertave hap zarfin e parë me mbishkrimin **“Dokumentacioni i kërkesave për kualifikim”** dhe administron në procesverbalin përkatës dokumentacionin për plotësimin e kërkesave ligjore, për kapacitetet ekonomike dhe financiare dhe për kapacitetin tekniko-profesional duke i bere të ditura ato për të gjithë pjesëmarrësit në sallën e hapjes se ofertave.

Komisioni i vlerësimit të ofertave hap zarfin e dytë me mbishkrimin **“Oferta tekniko-financiare”** dhe shënon në proces verbal të dhënat e tabelës se ofertës tekniko-financiare të dhëna nga ofertuesi, duke i bërë të ditura ato për të gjithë pjesëmarrësit në sallën e hapjes së ofertave.

Ky proces realizohet për të gjitha ofertat e marra për një objekt konkurrimi, duke i shënuar në proces verbalin përkatës që do të jetë pjesë e regjistrimit të konkurrimit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të reflektuara në procesverbalin e konkurrimit.

VLERËSIMI I OFERTAVE

Ofertat do të vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në bazë të kriterëve tekniko-financiare sipas metodikës së mëposhtme. Fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pikë më tepër në bazë të kriterëve tekniko-financiare.

AFATI I SHPALLJES SË RENDITJES PËRFUNDIMTARE NGA KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, BAZUAR NË OFERTAT E PRANUARA NË GARË.

1. Afati i vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të ofertave është deri në 30 (tridhjetë) ditë. Në raste të veçanta, me kërkesë të argumentuar të komisionit të vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktues mund ta ndryshojë këtë afat por jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike.
2. Kryetari i komisionit të vlerësimit, brenda 20 (njëzet) ditëve nga komunikimi me ofertuesit, përgatit raportin përmbledhës dhe ia propozon fituesin, dhe radhën e subjekteve sipas pikëve të fituara, titullarit të autoritetit kontraktues. Raporti përmban:
 - a) objektin minerar/zonën minerare;
 - b) një përmbledhje të procedurës së ndjekur;
 - c) numrin e ofertave të paraqitura dhe një përmbledhje për çdo ofertë;
 - d) kriteret e vlerësimit të ofertave dhe vlerësimin sipas këtyre kriterëve të secilës ofertë;
 - e) kriteret e përcaktimit të ofertës ekonomiko-financiare;
 - f) renditjen e ofertuesve sipas vlerësimit të komisionit të vlerësimit të ofertave;
 - g) ankesat, nëse ka.
3. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ në përputhje me parashikimet e VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar.
4. Pas përfundimit të afatit të bërjes së ankesës nga ofertuesit, autoriteti kontraktues njofton, fituesin për plotësimin e dokumentacionit për aplikimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit për marrjen e të drejtave minerare në zonën minerare të shpallur në konkurrim dhe dërgon njoftimin për ofertuesin fitues për publikim. Data e publikimit është data e përllogaritjes së afatit 60 ditor për përgatitjen e aplikimit për leje minerare.

ANKIMI ADMINISTRATIV DHE GJYQËSOR NË DISPOZICION TË OFERTUESVE

1. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur gjykon se një veprim i ndërmarrë nga Autoriteti kontraktues është në kundërshtim me parashikimet e VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar.
2. Ankesa kundër vendimeve të Autoritetit kontraktues paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik, jo me vonë se 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së subjektit fitues.
3. Me marrjen e ankesës me shkrim, Komisioni i Prokurimit Publik njofton autoritetin kontraktor në lidhje me pezullimin e procedurës së konkurimit, dhe fillimin e procedurave të hetimit administrative.
4. Komisioni i Prokurimit Publik nuk pezullon procedurën në rastet kur:
 - a. nga shqyrtimi paraprak rezulton se ankesa nuk është e argumentuar juridikisht;
 - b. pezullimi vjen në kundërshtim me interesin publik apo dëmton Autoritetin kontraktues ose ofertuesit e tjerë.
5. Gjatë shqyrtimit të ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:
 - a. të shfuqizojë pjesërisht apo plotësisht vendimet ose aktet e Autoritetit kontraktues;
 - b. ta udhëzojë Autoritetin kontraktues për korrigjimin e shkeljeve përpara vazhdimit të procedurave.
6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjatë procedurave të hetimit administrativ, ka të gjitha kompetencat e parashikuara nga ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
7. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën, në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij dhe Kodin e Procedurave Administrative.
8. Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 20 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankesës, përfundon hetimin administrativ dhe njofton Autoritetin kontraktues dhe ankuesin për vendimin.
9. Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik është akt administrativ përfundimtar.
10. Kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, ankuesi ka të drejtë që, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, të bëjë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në Gjykatën Administrative Tiranë.

ANEKSI I

FORMULARI ME INFORMACIONIN BAZË

Informacion për Ofertuesin:

Emri: _____

Lloji: _____

Regjistrimi si Person Juridik Nr: _____

Selia: _____

Adresa e Zyrës Qendrore: _____

Numri i telefonit: _____

Faksi: _____

E-mail: _____

Përfaqësuesi i shoqërisë në procedurën konkurruese: Z/Znj. _____

ANEKSI II

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Letër me logon e Bankës]
[Shtojce per tu paraqitur nga operatori ekonomik]

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmblidhjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar të aplikojë pranë QKB për t'u pajisur me Leje Minerare, pas marrjes së Njoftimit të fituesit;
- Ofertuesi nuk ka aplikuar pranë QKB për t'u pajisur me Leje Minerare, brenda 60 ditëve nga marrja e Njoftimit të fituesit
- Ofertuesi nuk ka paraqitur Garancine financiare të investimeve brenda 30 ditëve nga pajisja e tij nga QKB me Leje Minerare.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën 150 (ditë) që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave.

[Përfaqësuesi i bankës]

[Përfaqësuesi i shoqërisë]

ANEKSI III

[*Aneks per tu plotesuar nga Subjekti ofertues*]

DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

E operatorit ekonomik pjesemarres ne proceduren e prokurimit qe do të zhvillohet ne date _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____

Une i nenshkuari _____ me cilesine _____ te operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional,

Data e dorezimit te deklarates _____

Perfaqesuesi i ofertuesit

Nenshkrimi

Vula

ANEKSI IV - A

FORMULARI I OFERTES TEKNIKO FINANCIARE PER LEJE MINERARE SHFRYTEZIMI

<u>Formulari i Ofertes tekniko financiare</u> për realizimin e planit të investimit në objektin /zonën minerare nr.shpallur në planin vjetor minerar të vitit 201---, të përfshirë në qarkun e <u>PËR LEJE MINERARE SHFRYTËZIMI</u>			
Përshkrimi i kriterit teknik	Kushti minimal i ofertës	Dokumenti i ofertuesit	Vlerësimi për kriterin teknik
<u>Aftësitë tekniko profesionale të subjektit:</u> Historik i aktivitetit të shoqërisë; Referenca ku vërtetohet se subjekti ka realizuar më parë veprimtari minerare te ngjashme; Dëshmi të ndryshme profesionale të stafit të shoqërisë që do të punojnë për këtë veprimtari; Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve dhe numrit të stafit drejtues; Licencat profesionale që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit; Lista e mjeteve e shoqëruar me dokumenta që vërteton të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj mjetit (pronësi, qera, përdorim apo çdo lloj tjetër posedimi); Dokumente të tjerë që vërtetojnë kapacitetet tekniko-profesionale të subjektit.		Dokumentet e ofertuesit do të vlerësohen për: Eksperiencën në veprimtarinë minerare Efektiviteti në veprimtari të mëparshme minerare Përbërjen e stafit për veprimtarinë minerare Kualifikimet, certifikatat dhe licencat profesionale të stafit për veprimtarinë minerare; Eksperiencën e drejtuesit teknik Kapacitetet e mekanikes për veprimtarinë minerare	15 pikë
<u>Aftësitë ekonomiko-financiare të subjektit:</u> Kapaciteti financiar i shoqërisë sipas deklaratave bankare; Kapaciteti financiar që mund të sigurojë shoqëria ofertuese ose një shoqëri tjetër e cila i garanton mbështje financiare, vërtetuar nga dokumente notoriale dhe vërtetime të bankave; Pasqyrat financiare të certifikuara dhe Vërtetimet e xhirove vjetore		Dokumentet e ofertuesit që do të vlerësohen për kapacitetet ekonomiko-financiare të shoqërisë.	20 pikë

të shoqerise sipas bilanceve të miratuara, për kapacitetet e saj financiare. Dokumente që vërtetojnë investime të ngjashme të suksesshme të kompanisë; Plotësimin e Tabelës Nr 1 me parashikimin nga subjekti konkurrues me treguesit ekonomiko-financiare për aktivitetin minerar në zonën për të cilën po konkurron.			
Prodhimi që mendohet të realizohet në objektin/zonën minerare	Prodhimi minimal që kërkohet të realizohet në objektin/zonën minerare do të jetë jo me pak se ...(...) ton/m ³ në vit	Prodhimi minimal që do të realizohet në objektin/zonën minerare do të jetë ...(...) ton/m ³ në vit	15 pikë
Sasia e prodhimit që do të përpunohet	Nuk ka kriter minimal	Sasia e prodhimit që do të përpunohet do të jetë ...(...) ton/m ³ në vit	10 pikë
Përshkrimi i kriterit financiar	Kushti minimal i ofertës	Vlera e ofertuesit	Vlerësimi për kriterin financiar
Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare	Vlera minimale e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare është(.....) lek.	Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare është(.....) lek.	20 pikë
Të ardhurat që parashikohet të merren nga veprimtaria minerare e shfrytëzimit në objektin/zonën minerare	Nuk ka kriter minimal	Vlera e produkteve minerare që parashikohet të merren nga veprimtaria minerare në objektin/zonën minerare është(.....) lek.	10 pikë
IRR ne % (Koeficienti i rentabilitetit)	Nuk ka kriter minimal	Vlera e rentabilitetit ekonomik është (IRR=.....%)	10 pikë

Kujdes në formulimin e ofertës, nuk duhet të ketë forma alternative të paraqitjes së saj. Mosplotësimi korrekt i kërkesave përbën kusht skualifikimi. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës do të jetë: **150 ditë nga hapja e ofertës**. Vlera e projektit të ofruar të shprehet në monedhën: **Lekë**.

ANEKSI.IV.B**FORMULARI I OFERTES TEKNIKO FINANCIARE PER LEJE MINERARE KERKIM - ZBULIMI**

<u>Formulari i Ofertes tekniko financiare</u> për realizimin e planit të investimit në objektin /zonën minerare nr.shpallur në planin vjetor minerar të vitit 201---, të përfshirë në qarkun e <u>PËR LEJE MINERARE KËRKIM-ZBULIMI</u>			
Përshkrimi i kriterit teknik	Kushti minimal i ofertës që përgatitet nga Njësia e hartimit të dokumenteve	Dokumenti i ofertuesit	Vlerësimi për kriterin teknik
<u>Aftësitë tekniko profesionale të subjektit:</u> Historik i aktivitetit të shoqërisë; Referenca ku vërtetohet se subjekti ka realizuar më parë veprimtari minerare te ngjashme; Dëshmi të ndryshme profesionale të stafit të shoqërisë që do të punojnë për këtë veprimtari; Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve dhe numrit të stafit drejtues; Licencat profesionale që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit; Lista e mjeteve e shoqëruar me dokumenta që vërteton të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj mjetit (pronësi, qera, përdorim apo çdo lloj tjetër posedimi); Dokumente të tjerë që vërtetojnë kapacitetet tekniko-profesionale të subjektit.		Dokumentet e ofertuesit do të vlerësohen për: Eksperiencën në veprimtarinë minerare Efektiviteti në veprimtari të mëparshme minerare Përbërjen e stafit për veprimtarinë minerare Kualifikimet, certifikatat dhe licencat profesionale të stafit për veprimtarinë minerare; Eksperiencën e drejtuesit teknik Kapacitetet e mekanikes për veprimtarinë minerare	20 pikë
<u>Aftësitë ekonomiko-financiare të subjektit:</u> Kapaciteti financiar i shoqërisë sipas deklaratave bankare; Kapaciteti financiar që mund të sigurojë shoqëria ofertuese ose një shoqëri tjetër e cila i garanton mbështje financiare, vërtetuar nga dokumente		Dokumentet e ofertuesit që do të vlerësohen për kapacitetet ekonomiko-financiare të shoqërisë.	20 pikë

noteriale dhe vërtetime të bankave; Pasqyrat financiare të certifikuara dhe Vërtetimet e xhirove vjetore të shoqërisë sipas bilanceve të miratuara, për kapacitetet e saj financiare. Dokumente që vërtetojnë investime të ngjashme të suksesshme të kompanisë; Plotësimin e Tabelës Nr 1 me parashikimin nga subjekti konkurrues me treguesit ekonomiko-financiare për aktivitetin mineral në zonën për të cilën po konkurron.			
Përshkrimi i kriterit financiar	Kushti minimal i ofertës	Vlera e ofertuesit	Vlerësimi për kriterin financiar
Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare	Vlera minimale e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare është(.....) lek.	Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare është(.....) lek.	30 pikë
Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer për punime minerare kërkim-zbulimi në objektin/zonën minerare e shprehur në % të vlerës totale të investimit.	Nuk ka kriter minimal	Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer për punime minerare kërkim-zbulimi në objektin/zonën minerare është.....(.....) %.	30 pikë
TOTALI			100 pikë

Kujdes në formulimin e ofertës, nuk duhet të ketë forma alternative të paraqitjes së saj. Mosplotësimi korrekt i kërkesave përbën kusht skualifikimi. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës do të jetë: **150 ditë nga hapja e ofertës**. Vlera e projektit të ofruar të shprehet në monedhën: **Lekë**.

ANEKSI.V

TABELA NR 1													
Parashikimi nga Subjekti konkurrues _____ i disa treguesve ekonomik-financiare të aktivitetit mineral në zonën konkurruese _____ për leje shfrytëzimi mineral.													
Nr	Emërtimi treguesit	Njësi e matjes	Treguesit e parashikuar sipas viteve, në rast se subjekti do të ushtronte aktivitet shfrytëzimi në zonën konkurruese										Totali
			Viti I	Viti II	Viti III						Viti parafundit	Viti fundit	
1	PRODIMI MINERAL GJITHSEJ	ton/vit; m ³ / vit											
	Nga ky, sipas llojeve:												
1.1	Prodhim minerali												
1.2	Prodhim koncentratit												
1.3	prodhim....												
1.4	prodhim.....												
1.5													
2	PRODIMI i shitshëm gjithsej	ton/vit; m ³ / vit											
	Nga ky, sipas llojit që do të shitet:												
2.1													
2.2													
2.3													
3	ÇMIMET E SHITJES:	laka/ton; laka/m ³											
	Nga këto, çmimet sipas llojit të prodhimit që shitet:												
3.1													
3.2													
3.3													
4	TE ARDHURAT NGA SHITJA, nga këto	mijë laka											
	Sipas prodhimit që do të shitet:												
4.1													
4.2													
4.3													
A	TOTALI TE ARDHURA	mijë laka											
5	KOSTOT OPERATIVE sipas llojit të prodhimit:	laka/ton											
5.1													
5.2													
5.3													

Nr	Emërtimi treguesit	Njësi e matjes	I reguesit e parashikuar sipas viteve, ne rast se subjekti do te ushtrroje aktivitet shpirtëzuesim ne zonen konkurruese										Totali
			Viti I	Viti II	Viti III						Viti parafundit	Viti fundit	
6	SHPENZIME OPERATIVE :	laks/ton; laks/m3											
	Nga keto shpenzime per secilin lloj prodhimi												
6.1													
6.2													
6.3													
6.4													
7	SHPENZIME TE TJERA për aktivitetin minerar në zonen konkurruese (këtu nuk përfshihen taksat). Nga këto:	mijë laks											
7.1													
7.2													
7.3													
8	TAKSAT GJITHSEJ pa TVSH në për investimet, e cila raportohet veças në këtë tabelë, shif treguesin me Nr. 12.	mijë laks											
	Nga keto:												
11.1	Renta minerare												
11.2	Taksa...												
11.3	taksa...												
11.4													
11.5													
B	TOTALI SHPENZIMEVE për aktivitet në zonen konkurruese (B=6+7+8)	mijë laks											
9	FITIMI PARA TATIMIT (9=A-B)												
C	TATIM FITIMI	mijë laks											
10	FITIMI NETO nga aktiviteti minerar në zonën konkurruese (10= A-B-C)	mijë laks											

Nr	Emërtimi treguesit	Njësi e matjes	I regjestrat e parashikuar sipas viteve, në rast se subjekti do të ushtronte aktivitet shfrytëzues në zonën konkurruese										Totali
			Viti I	Viti II	Viti III						Viti parafundit	Viti fundit	
11	INVESTIMET TOTALE për zonën konkurruese (pa TVSH-në dhe pa garancinë e investimeve), nga këto sipas objektit:	mijë lekë											
11.1		mijë lekë											
11.2		mijë lekë											
11.3		mijë lekë											
11.4		mijë lekë											
11.5		mijë lekë											
11.6	Garanci për rihabilitim mjedisi	mijë lekë											
12	TVSH për INVESTIMET në zonën konkurruese	mijë lekë											
D	INVESTIMI TOTAL ME TVSH (D=11+12)	mijë lekë											
E	GARANCI për INVESTIMET në zonën konkurruese												
13	Parashikimi CASH FLOW nga aktiviteti në zonën konkurruese (13=A-B-C-D-E)	mijë lekë											
14	IRR (koeficienti i rentabilitetit në %)	mijë lekë											

Konfirmues: Administratori i Subjektit Konkurses _____ për zonën _____ e publikuar për konkurim.

(EMRI, MBTEMRI, FIRMA)

ANEKSI VI – A

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT **PËR LEJE MINERARE SHFRYTËZIMI**

Ofertat do të vlerësohen nga Autoriteti Kontraktues në bazë të kriterëve të mëposhtme, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pikë më tepër në baze të kriterëve të vlerësimit. Ato oferta, që në thelb nuk pajtohen me përshkrimin e subjektit të procedurës konkurruese, do të refuzohen.

Shpjegime për kriteret e përzgjedhjes së fituesit dhe metodologjinë e vlerësimit gjatë procedurës konkurruese PËR LEJET E SHFRYTËZIMIT:

Vlerësimi për kriteret tekniko-financiare do të kryhet me pikë. Subjektet do të rreshtohen sipas numrit maksimal të pikëve dhe subjekti fitues do të jetë ai subjekt i cili siguron numrin maksimal të pikëve sipas kriterëve tekniko-financiare, dhe do të jetë subjekti i cili fiton të drejtën për aplikim për leje minerare brenda një periudhe 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike për objektin e konkurrimit (zonën konkurruese) pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në të njëjtën kohë subjekti duhet të aplikojë dhe për lejen mjedisore për këtë zonë minerare sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin. Metodologjia e vlerësimit të ofertave tekniko-financiare jepet më poshtë:

<u>Kriteret teknike dhe financiare</u> për realizimin e planit të investimit në objektin,/zonën minerare nr.shpallur në planin vjetor minerar të vitit 201---, të përfshirë në qarkun e			
<u>PËR LEJE MINERARE SHFRYTËZIMI</u>			
<i>Përshkrimi i kriterit teknik</i>	<i>Vlera maksimale e pikëve për:</i>	<i>Vlerësimi në pikë</i>	<i>Formula e llogaritjes në pikë për vlerat e ofertuesve</i>
Aftësitë tekniko-profesionale të subjektit	Nuk ka kriter minimal por jo më shumë se 15 pikë	15 pikë	$ATPi = \text{Pikët sipas Komisionit të Vlerësimit të ofertave}$
Aftësitë ekonomiko-financiare të subjektit	Nuk ka kriter minimal por jo më shumë se 20 pikë	20 pikë	$AEFi = \text{Pikët sipas Komisionit të Vlerësimit të ofertave}$
Prodhimi që mendohet të realizohet në objektin/zonën minerare	Vlerën maksimale të kriterit	15 pikë	$P_i = \frac{P_i}{P_{\max}} \times 15$

Sasia e prodhimit që do të përpunohet	Vlerën maksimale të kriterit	10 pikë	P_{pi} $P_{pi} = \frac{\text{-----}}{P_{p_{max}}} \times 10$
<i>Përshkrimi i kriterit financiar</i>	<i>Vlera maksimale e pikëve për:</i>	<i>Vlerësimi në pikë</i>	<i>Formula e llogaritjes në pikë për vlerat e ofertuesve</i>
Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare	Vlerën maksimale të kriterit	20 pikë	V_{INi} $V_{INi} = \frac{\text{-----}}{V_{IN_{max}}} \times 20$
Vlera e produkteve minerare që parashikohet të merren nga veprimtaria minerare në objektin/zonën minerare (kur kemi të bëjmë me leje minerare shfrytëzimi)	Vlerën maksimale të kriterit	10 pikë	V_{Pi} $V_{Pi} = \frac{\text{-----}}{V_{P_{max}}} \times 10$
IRR ne % (Koeficienti i rentabilitetit)	Nivelin maksimal të kriterit	10 pikë	V_{Ren_i} $V_{Peri} = \frac{\text{-----}}{V_{Ren_{max}}} \times 10$
TOTALI I PIKËVE		100 pikë	$P_{ti} = ATPi + AEFi + Pi + P_{pi} + V_{INi} + V_{Pi} + V_{Peri}$

Ku:

P_{ti} ----- ***Pikët totale të llogaritura të ofertuesit (i)***

$ATPi$ ----- Pikët që merr ofertuesi për aftësitë e tij tekniko-profesionale sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi.

$AEFi$ ----- Pikët që merr ofertuesi për aftësitë e tij ekonomiko-financiare sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi.

P_i ----- Prodhimi që do të realizohet në objektin/zonën minerare nga ofertuesi

P_{max} ----- Prodhimi maksimal që do të realizohet në objektin/zonën minerare

P_{pi}	-----Sasia e prodhimit që do të përpunohet nga ofertuesi
$P_{p_{max}}$	----- Sasia maksimale e prodhimit që do të përpunohet
V_{Ni}	-----Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer nga ofertuesi
$V_{N_{max}}$	-----Vlera maksimale e investimit që parashikohet për tu kryer
V_{pi}	-----Vlera e produkteve minerare nga ofertuesi
$V_{p_{max}}$	----- Vlera maksimale e produkteve minerare
V_{Reni}	----- Vlera e rentabilitetit nga ofertuesi
$V_{Ren_{max}}$	-----Vlera maksimale e rentabilitetit

Shpjegimi i kritereve të vlerësimit

Kriteret teknike

1. Aftësitë tekniko profesionale të subjektit

Pavarësisht dokumenteve të kualifikimit për plotësimin e kërkesave tekniko-profesionale në formularin e ofertës teknike-financiare subjekti duhet të japë informacion dhe dokumente që vërtetojnë aftësitë e tij tekniko-profesionale për të cilat ai do të vlerësohet në lidhje me Eksperiencën e tij në veprimtari minerare, Efektivitetin e investimeve të realizuara prej tij në veprimtari të mëparshme minerare, Përbërjen e stafit për veprimtarinë minerare sipas aktivitetit që mendohet të realizohet në zonën minerare të hedhur për konkurrim, Kualifikimet, certifikatat dhe licencat profesionale të stafit për veprimtarinë minerare; Eksperiencën e drejtuesit teknik, Kapacitetet e mekanikes për veprimtarinë minerare që lidhen me mekanizimin e proceseve në veprimtarinë minerare. Subjekti i cili sipas kritereve të mësipërme vlerësohet me eksperiencë dhe kualifikim me të lartë profesional për të kryer veprimtari minerare në këtë objekt minerar do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

2. Aftësitë ekonomiko-financiare të subjektit

Pavarësisht dokumentit të kualifikimit për plotësimin e kërkesës minimale për kapacitetet ekonomiko-financiare në formularin e ofertës teknike-financiare subjekti duhet të japë informacion dhe dokumente që vërtetojnë mundësitë e tij financiare si dhe burimet financiare që ai mendon të përfshijë në veprimtarinë minerare në këtë zonë minerare konkurruese. Subjekti, i cili ka potencialin me të madh financiar dhe qëllimin e investimit të këtij potenciali në këtë objekt minerar do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

3. Prodhimi që mendohet të realizohet në objektin/zonën minerare

Mbi bazën e të dhënave për zonën minerare subjekti duhet të programojë prodhimin që ai mendon të realizojë në këtë zonë minerare bazuar kjo në investimin që ai mendon të realizojë dhe mundësitë e tij financiare dhe tekniko-profesionale për zhvillimin e veprimtarisë minerare në këtë zonë. Vlera e prodhimit

do të jepet në ton/m³, në mënyrë që të jetë e krahasueshme për të gjithë ofertat në garë. Kjo vlerë nuk mund të jetë më e vogël se vlera e prodhimit minimal të dhënë në të dhënat për këtë zonë minerare, e cila përcakton dhe vlerën minimale të këtij kriteri. Subjekti i cili parashikon prodhimin maksimal në këtë objekt minerar do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

4. Sasia e prodhimit që do të përpunohet

Mbi bazën e të dhënave për zonën minerare subjekti duhet të programojë sasinë prodhimit të mineralit të nxjerrë, i cili do të kalojë në procesin e përpunimit, i cili mund të përfshijë disa stade përpunimi pasurim, metalurgji apo procese të tjera për produktin e gatshëm. Subjekti, i cili parashikon sasinë maksimale të prodhimit që shkon në përpunim për këtë objekt minerar do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

Kriteret teknike

5. Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare

Mbi bazën e të dhënave për zonën minerare subjekti duhet të programojë vlerën e investimit, që ai mendon të realizojë në këtë zonë minerare bazuar kjo në vlerën e prodhimit të parashikuar që ai mendon të realizojë dhe mundësitë e tij financiare dhe tekniko-profesionale për zhvillimin e veprimtarisë minerare në këtë zonë. Vlera e investimit duhet të kuotohet në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse këto vlera kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare dhe kursi i këmbimit duhet të jetë ai i fiksuar nga Banka e Shqipërisë në ditën kur publikohet njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhet në atë kurs këmbimi deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, në mënyrë që të jetë e krahasueshme për të gjithë ofertat në garë. Kjo vlerë nuk mund të jetë më e vogël se vlera minimale e investimit të dhënë në të dhënat për këtë zonë minerare e cila përcakton dhe vlerën minimale të këtij kriteri. Subjekti i cili parashikon sasinë maksimale të investimit për veprimtarinë minerare në këtë zonë minerare do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

6. Vlera e produkteve minerare që parashikohet të merren nga veprimtaria minerare në objektin/zonën minerare (kur kemi të bëjmë me leje minerare shfrytëzimi)

Subjekti duhet të programojë stadet e përpunimit të mineralit të nxjerr realizojë nga zona minerare dhe si rezultat dhe produktet e gatshme që ai mendon të nxjerrë në treg dhe sasinë e tyre të bazuar në sasinë e prodhimit të mineralit të nxjerrë, i cili do të kalojë në procesin e përpunimit, i cili mund të përfshijë disa stade përpunimi pasurim, metalurgji apo procese të tjera për produktin e gatshëm. Sipas stadeve të përpunimit do të kemi dhe një vlerë të shtuar të produkteve minerare të gatshme për tu hedhur në treg dhe të prodhuar nga kjo zonë minerare. Vlera e produkteve të gatshme që do të hidhen në treg duhet të kuotohet në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH, duke patur parasysh vlerën e tregut në bursat ndërkombëtare dhe për ato produkte që shiten në vend vlerën e tregut në vend, vlerë e cila do të vlerësohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave. Nëse këto vlera kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare dhe kursi i këmbimit duhet të jetë ai i

fiksuar nga Banka e Shqipërisë në ditën kur publikohet njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhet në atë kurs këmbimi deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, në mënyrë që të jetë e krahasueshme për të gjithë ofertat në garë. Subjekti i cili parashikon vlerën maksimale të produkteve të gatshme të marra nga kjo zonë minerare do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

7. *IRR* ne % (Koeficienti i rentabilitetit)

IRR - Koeficienti i rentabilitetit të investimit do të përcaktohet nga një cashflow paraprak bazuar në vlerat e investimit, sasinë e prodhimit dhe sasinë e produkteve të gatshëm të kësaj zonë minerare (sipas Tabelës Nr. 1). Kjo vlerë duhet të jepet në përqindje. Subjekti, i cili parashikon dhe rezulton me vlerën maksimale të IRR për veprimtarinë minerare në këtë zonë minerare do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

ANEKSI VI – B

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT PËR LEJE MINERARE KËRKIM-ZBULIMI

Ofertat do të vlerësohen nga Autoriteti Kontraktues në bazë të kriterëve të mëposhtme, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pikë më tepër në baze të kriterëve të vlerësimit. Ato oferta, që në thelb nuk pajtohen me përshkrimin e subjektit të procedurës konkurruese, do të refuzohen.

Shpjegime për kriteret e përzgjedhjes së fituesit dhe metodologjinë e vlerësimit gjatë procedurës konkurruese PËR LEJET E KËRKIM-ZBULIMIT:

Vlerësimi për kriteret tekniko-financiare do të kryhet me pikë. Subjektet do të rreshtohen sipas numrit maksimal të pikëve dhe subjekti fitues do të jetë ai subjekt, i cili siguron numrin maksimal të pikëve sipas kriterëve tekniko-financiare, dhe do të jetë subjekti i cili fiton të drejtën për aplikim për leje minerare brenda një periudhe 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike për objektin e konkurrimit (zonën konkurruese) pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në të njëjtën kohë subjekti duhet të aplikojë dhe për lejen mjedisore për këtë zonë minerare sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin. Metodologjia e vlerësimit të ofertave tekniko-financiare jepet më poshtë:

<u>Kriteret teknike dhe financiare</u> për realizimin e planit të investimit në objektin /zonën minerare nr.shpallur në planin vjetor minerar të vitit 201---, të përfshirë në qarkun e <u>PËR LEJE MINERARE KËRKIM-ZBULIMI</u>			
<i>Përshkrimi i kriterit teknik</i>	<i>Vlera maksimale e pikëve për:</i>	<i>Vlerësimi në pikë</i>	<i>Formula e llogaritjes në pikë për vlerat e ofertuesve</i>
Aftësitë tekniko-profesionale të subjektit	Nuk ka kriter minimal por jo me shume se 20 pikë	20 pikë	ATPi=Pikët sipas Komisionit të Vlerësimit të ofertave
Aftësitë ekonomiko-financiare të subjektit	Nuk ka kriter minimal por jo me shume se 20 pikë	20 pikë	AEFi=Pikët sipas Komisionit të Vlerësimit të ofertave
<i>Përshkrimi i kriterit financiar</i>	<i>Vlera maksimale e pikëve për:</i>	<i>Vlerësimi në pikë</i>	<i>Formula e llogaritjes në pikë për vlerat e ofertuesve</i>
Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare	Vlerën maksimale të kriterit	30 pikë	$\frac{VIN_i}{VIN_{max}} \times 30$
Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer për punime minerare kërkim-zbulimi në	Vlerën maksimale të kriterit	30 pikë	$\frac{VPkz_i}{VPkz_{max}} \times 30$

objektin/zonën minerare e shprehur në % kundrejt vlerës totale të investimit.			
TOTALI I PIKËVE		100 pikë	$P_{ti}=ATP_i+AEF_i+VIN_i+VPk_{zi}$

Ku:

P_{ti} ----- Pikët totale të llogaritura të ofertuesit (i)

ATP_i ----- Pikët që merr ofertuesi për aftësitë e tij tekniko-profesionale sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi.

AEF_i ----- Pikët që merr ofertuesi për aftësitë e tij ekonomiko-financiare sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi.

VIN_i ----- Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer nga ofertuesi

VIN_{max} ----- Vlera maksimale e investimit që parashikohet për tu kryer

VPk_{zi} ----- Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer nga ofertuesi për punimet e kërkim - zbulimit e shprehur në përqindje karshi vlerës totale të investimit

$VPk_{z_{max}}$ ----- Vlera maksimale e investimit që parashikohet për tu kryer për punimet e kërkim - zbulimit e shprehur në përqindje karshi vlerës totale të investimit

Shpjegimi i kriterëve të vlerësimit

Kriteret teknike

1. Aftësitë tekniko profesionale të subjektit

Pavarësisht dokumenteve të kualifikimit për plotësimin e kërkesave tekniko-profesionale në formularin e ofertës teknike-financiare subjekti duhet të japë informacion dhe dokumente që vërtetojnë aftësitë e tij tekniko-profesionale për të cilat ai do të vlerësohet në lidhje me Eksperiencën e tij në veprimtari minerare, Efektivitetin e investimeve të realizuara prej tij në veprimtari të mëparshme minerare, Përbërjen e stafit për veprimtarinë minerare sipas aktivitetit që mendohet të realizohet në zonën minerare të hedhur për konkurrim, Kualifikimet, certifikatat dhe licencat profesionale të stafit për veprimtarinë minerare; Eksperiencën e drejtuesit teknik, Kapacitetet e mekanikës për veprimtarinë minerare që lidhen me mekanizimin e proceseve në veprimtarinë minerare. Subjekti i cili sipas kriterëve të mësipërme vlerësohet me eksperiencë dhe kualifikim më të lartë profesional për të kryer veprimtari minerare në këtë objekt mineral do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

2. Aftësitë ekonomiko-financiare të subjektit

Pavarësisht dokumentit të kualifikimit për plotësimin e kërkesës minimale për kapacitetet ekonomiko-financiare në formularin e ofertës teknike-financiare subjekti duhet të japë informacion dhe dokumente që vërtetojnë mundësitë e tij financiare si dhe burimet financiare që ai mendon të përfshijë në veprimtarinë minerare në këtë zonë minerare konkurruese. Subjekti i cili ka potencialin më të madh financiar dhe

qëllimin e investimit të këtij potenciali në këtë objekt mineralar do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

Kriteret teknike

3. *Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare*

Mbi bazën e të dhënave për zonën minerare subjekti duhet të programojë vlerën e investimit, që ai mendon të realizojë në këtë zonë minerare bazuar kjo në sipërfaqen e zonës minerare që kërkohet të kërkohet dhe zbulohet dhe mundësitë e tij financiare dhe tekniko-profesionale për zhvillimin e veprimtarisë minerare në këtë zonë. Vlera e investimit duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse këto vlera kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare dhe kursi i këmbimit duhet të jetë ai i fiksuar nga Banka e Shqipërisë në ditën kur publikohet njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhet në atë kurs këmbimi deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, në mënyrë që të jetë e krahasueshme për të gjithë ofertat në garë. *Kjo vlerë nuk mund të jetë më e vogël se vlera minimale e investimit të dhënë në të dhënat për këtë zonë minerare e cila përcakton dhe vlerën minimale të këtij kriteri.* Subjekti, i cili parashikon sasinë maksimale të investimit për veprimtarinë minerare në këtë zonë minerare do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

4. *Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin/zonën minerare për punimet e kërkim zbulimit*

Mbi bazën e të dhënave për zonën minerare subjekti duhet të programojë vlerën e investimit për punimet minerare të kërkim zbulimit në vlerën e tyre në përqindje kundrejt vlerës totale të investimit që përfshin vlerën e investimit që realizohet për punimet e kërkim zbulimit kjo e përcaktuar nga sipërfaqja e zonës se lejuar minerare, shpërndarja e trupave, rrjeti i kërkim-zbulimit që do të përdoret dhe mundësitë e tij financiare dhe tekniko-profesionale për zhvillimin e veprimtarisë minerare në këtë zonë. Vlera e investimit duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse këto vlera kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare dhe kursi i këmbimit duhet të jetë ai i fiksuar nga Banka e Shqipërisë në ditën kur publikohet njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhet në atë kurs këmbimi deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, në mënyrë që të jetë e krahasueshme për të gjithë ofertat në garë. *Kjo vlerë nuk mund të jetë më e vogël se vlera minimale e investimit të dhënë në të dhënat për këtë zonë minerare e cila përcakton dhe vlerën minimale të këtij kriteri.* Subjekti, i cili parashikon sasinë maksimale të investimit për veprimtarinë minerare në këtë zonë minerare do të vlerësohet me Pikët maksimale për këtë kriter.

Ndalimi i negociatave

Nuk do të kryhet asnjë negociatë me Ofertuesin në lidhje me ofertën e tij.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë ofertuesit të sqarojë ofertën e tij, pa bërë asnjë ndryshim në thelbin e saj.

ANEKSI VII - 1

Lënda: DËRGOHET NJOFTIMI I FITUESIT

Nr. i Referencës së zonës minerare: Zona Minerare Konkurruese nr..... (për objektin),
Qarku i e miratuar në planin vjetor minerar të vitit 201__.

[Adresa e ofertuesit fitues]

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron [emri dhe adresa e Ofertuesit fitues] se oferta e paraqitur më datë [data] për përfitimin e të drejtës për aplikimin për leje minerare në zonën minerare nr..... për vlerën totale të investimit prej [shuma në fjalë dhe shifra], vlerën e prodhimit të mineralit prej [shuma në fjalë dhe shifra], është pranuar si oferta e parë me Pikët më të larta në procesin e konkurrimit për të drejtën e aplikimit për leje minerare në Zonën Minerare Konkurruese nr..... (për objektin), Qarku i e miratuar në planin vjetor minerar të vitit 201__.

Ofertuesi [emri] kërkohet t'i paraqesë [emri dhe adresa e Autoritetit kontraktues]:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Njoftimit, të nënshkruar.
- Në rast se tërhiqeni nga aplikimi për lejen minerare duhet të njoftoni me shkrim jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij njoftimi.

KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

Belinda Balluku

ANEKSI VII – 2

Lënda: DËRGOHET FORMULARI I NJOFTIMIT PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR

Nr. i Referencës së zonës minerare: Zona Minerare Konkurruese nr.....(për objektin.....), Qarku i e miratuar në planin vjetor mineral të vitit 201__.

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z./Znj. <emri i personit të kontaktit të ofertuesit sipas zarfit të ofertës>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur konkurruese, procedurë e kryer në përputhje me kërkesat e nenit 5 pika 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikës 5 dhe pikave 7/7 e 7/8 të VKM nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar, dhe Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr....., datë “Për miratimin e planit vjetor mineral për vitin”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes, sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e ofertës.

Me keqardhje ju informojmë se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme : *[shënoni kutinë e duhur]*:

[subjekti juaj] [drejtuesi juaj ekzekutiv]

- ☐ Është gjykuar nga një gjykatë që gëzon juridiksionin kompetent se ka kryer një shkelje kriminale ose civile, që përfshin praktikat korruptive, pastrimin e parave, organizimin kriminal ose aktivitetet e përshkruara në ligjet ose rregullat e zbatueshme në Shqipëri, ose sipas marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare;
- ☐ Një gjykatë me juridiksion kompetent ka vendosur se ka kryer një veprim mashtrimi ose një veprim të njëvlershëm me mashtrimin;
- ☐ Është dënuar nga një gjykatë me juridiksion kompetent, për sjellje të gabuar profesionale;
- ☐ Është në ndjekje penale për një nga veprat penale të përshkruara në legjislacionin në fuqi.
- ☐ Ka falimentuar, aktiviteti është marrë nën administrimin e gjykatës;
- ☐ Është nën procedurën e deklarimit të falimentimit, sipas një urdhri për likuidim të detyruar ose administrim nga gjykata, ose sipas një marrëveshjeje me kreditorët, ose sipas procedurave të ngjashme;
- ☐ Është dënuar me vendim të formës së prerë për shkelje penale, në përputhje me nenin 45/1 të Ligjit për prokurimet publike;
- ☐ Nuk ka paguar kontributet e sigurimit shoqëror, në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;
- ☐ Nuk ka përmbushur detyrimet lidhur me pagimin e tatimeve, në përputhje me Ligjin Shqiptar ose me dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;

Nuk arritët të paraqisni:

- ☐ Vërtetime të mjaftueshme, siç përshkruhen që tregojnë se kandidati ose ofertuesi në fjalë i plotëson kërkesat për kapacitetet minimale financiare, të specifikuara në kriteret e kualifikimit të Dokumentave Standarte të Procedures Konkurruese;
- ☐ Dokumenta ose vërtetime të tjera të mjaftueshme që kërkohen nga autoriteti kontraktues, me qëllim verifikimin e përshtatshmërisë suaj teknike dhe profesionale;
- ☐ Autoriteti Kontraktues ka vendosur se ju keni dorëzuar dokumente që përmbajnë informacion të rremë ose dokumente të falsifikuara, me qëllim kualifikimi;
- ☐ Nuk arritët të plotësonit kërkesat për sigurimin e ofertës;
- ☐ Oferta juaj [nuk i përgjigjet kërkesave] [është e parregullt];
- ☐ (ndonjë shkak tjetër përveç atyre më sipër)

JUSTIFIKIMI

Jeni skualifikuar, pra oferta juaj u refuzua për shkak të këtyre arsyeve, si më poshtë:

[Shënoni arsyet e hollësishme për skualifikimin ose refuzimin e ofertës në fjalë]

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, të ndryshuar, gjatë procedurës konkurruese, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi, siç parashikohet në legjislacionin e mësipërm.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të konkurrimit.

KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

Belinda Balluku

ANEKSI VII – 3

FORMULARI I ANKESËS PËR PROCEDURËN KONKURRUESE

Ankesë drejtuar: ☐

Ankesë drejtuar: Avokati i Prokurimeve ☐

Ankesë drejtuar: Kryetarit të autoritetit Kontraktues ☐

(Shënoni një nga kutitë)

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Seksioni IV. Kundërshtimi Paraprak ndaj Autoritetit Kontraktues

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejtpërdrejt autoritetit kontraktues. Bashkëngjisni një kopje të çdo ankesë me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.

1. **Keni bërë ndonjë kundërshtim të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (p.sh., me shkrim, nëpërmjet faksit, etj).**

Po

☐

Jo

☐

2. **Autoriteti kontraktues Pranë të Cilit është bërë Kundërshtimi**

Emri i autoritetit kontraktues.

Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.

3. **Natyra e Masës së Kërkuar Korrigjuese**

Çfarë mase korrigjuese kërkon?

4. **Lista**

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkëngjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumenteve që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumenteve. Dokumentet duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentet e procedurës konkurruese, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë.** Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumenteve përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për konkurrimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: organit kompetent sipas VKM nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, të ndryshuar.

Një kopje e kësaj ankese duhet t’i dërgohet njëkohësisht Avokatit të Prokurimeve.

Nr. Faks:

E-mail:

Nënshkrimi dhe Vula e ankuesit

ANEKSI VII – 4

FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË SUBJEKTIT FITUES

1. Autoriteti Kontraktues

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Adresa: Rr. "Abdi Toptani" Tiranë

Internet: www.infrastruktura.gov.al

2. Lloji i autoritetit kontraktues dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion Qëndror	Institucion i Pavarur
X	☐
Njësitë e Qeverisjes Vendore	Tjetër
☐	☐

3. Objekti i Procedurës konkurruese

Për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën Kombëtare të Biznesit për zonën minerare konkurruese nr....., të miratuar në planin vjetor minerar të vitit 201__.

4. Vendndodhja e objektit të Procedurës konkurruese

....., qarku

5. Numri i ofertave të dorëzuara: ☐☐☐☐☐☐ Numri i ofertave të rregullta: ☐☐☐

6. Referenca e dosjes, e përcaktuar sipas autoritetit kontraktues:

Procedura konkurruese për dhënien e të drejtës minerare për zonën minerare konkurruese nr. _____

7. Emri dhe adresa e subjektit fitues

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Adresa e Internetit _____

8. Vlerat e investimit, prodhimit përfundimtar të ofertës:

Vlera e investimit	(pa TVSH) -monedha në lek
--------------------	---------------------------

-----	-----
Vlera e prodhimit	(në ton/m ³)
-----	-----

9. Publikime të mëparshme, lidhur me të njëjtën kontratë (nëse zbatohet):

Buletini i Njoftimeve Publike	Data	_____	Numri	_____
----------------------------------	------	-------	-------	-------

10. Informacione shtesë

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi /.../201__